



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 18

Datë: 23. 05. 2019. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Čemailj Kurtišti.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Përkthyes: Vera Dula. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.
2. Shpallja e rezultateve përfundimtare nga QNR-ja, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq.
3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Përsëritje të gjithëve, e hapi këtë mbledhje...Përpara se të votojmë, propozoj edhe një pikë: “Formimi i panelit për konkursin për Zëvendës kryeshef”... Në ndërkohë, ne kemi marrë imell nga z. Veselnovi i cili, ka bërë vërejtje që nuk është marrë parasysh kërkesa që ky konkurs të anulohet, dhe se formimi i panelit është në kundërshtim me rregulloren tonë... Pra, ta shqyrtojmë edhe njëherë këtë çështje..

Kush është për këtë rend dite, me këtë propozim...?

Anëtarët e KQZ-së, votuan rendin e ditës.

2.Shpallja e rezultateve përfundimtare nga QNR-ja, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq

Valdete Daka: I keni rezultatet të gjithë, sipas komunave:

1.Komuna e Leposaviqit

Lëvizja “VETËVENDOSJE”: Kandidati Fisnik Veseli ka marrë 105 vota apo 1.4%.

Partia Demokratike e Kosovës: Kandidati Shaqir Hetimi ka marrë 144 vota apo 1.9%.

Serbska Lista: Kandidati Zoran Todiç ka marrë 7296 vota, apo 96.7%.

Fitues, është kandidati i Listes Serbska

2. Komuna e Zubin Potokut

Lëvizja “VETËVENDOSJE”: Kandidatja Liridona Krahrimani ka marrë 110 vota, apo 2.6%.

Partia Demokratike e Kosovës: Kandidati Hysen Mehmeti ka marrë 123 vota, apo 2.9%

Serbska Lista: Kandidati Sergjan Vuloviç ka marrë 4075 vota, apo 94.6%.

Fitues, është kandidati i Listes Serbska.

3.Komuna e Zveqanit

Lëvizja “VETËVENDOSJE”: Kandidati Avdi Peci ka marrë 82 vota, apo 2.0%.

Partia Demokratike e Kosovës: Kandidati Ilir Peci ka marrë 131 vota, apo 3.2%.

Serbska Lista: Kandidatja Vuçina Jankovica ka marrë 3847 vota, apo 94.8%.

Fitues, është kandidati i Listes Serbska.

4.Mitrovica e Veriut

Lëvizja “VETËVENDOSJE”: Kandidati Erden Atiq ka marrë 331 vota, apo 4.0%.

Partia Demokratike e Kosovës: Kandidatja Gonxhe Çaushi ka marrë 461 vota, apo 5.6%.

Lista Serbska: Kandidati Goran Rakiç ka marrë 7484 vota, apo 90.4%.

Fitues, është kandidati i Listes Serbska.

Tani, pas publikimit të këtyre rezultateve, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan shpalljen e rezultateve përfundimtare nga QNR-ja për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq

Njëkohësisht, e njoftoj opinionin dhe të gjithë ata që kanë eventalisht vërejtje, që nga ky moment për 24 orë, rrjedh afat i ankesave në PZAP.

3. Formimi i panelit për konkursin për Zëvendës kryeshef

Valdete Daka: Siç thash në fillim të mbledhjes, në fakt propozova që të diskutojmë rreth formimit të panelit për konkursin për zëvendës kryeshef, dhe drejtor të ZRPP-së. Anëtari i KQZ-së, z. Stevan Veselinoviq, ka një propozim që sipas tij, çështja nuk është hedhur në votim...Pra, propozimi i tij nuk është hedhur në votim, dhe paneli është zgjedhur në kundërshtim me rregulloren. Prandaj, unë propozoj që të huhet në votim...

Florian Dushi: Do të thotë, janë dy situata që duken të ndërlidhura, por formimi i panelit nuk është në kundërshtim me rregulloren. Sepse, gjykoj që kjo është bërë edhe mbi bazën e rregullores, dhe është miratuar me shumicë votash. Prandaj, unë nuk kisha dëshiruar me i ndërlidhë këto dy veprime. Por, jam i pajtimit që ta rivotojmë panelin, por nuk ndërlidhi këto dy gjëra dhe nuk i konsideroj të kontestueshme në raport me rregulloren.

Adnan Rrustemi: Pajtohem që nuk ka ndërlidhje vendimi për votimin e panelit, me mos hedhjen në votim të propozimit të anëtarit të KQZ-së. Megjithatë, bile mendoj që propozimi është i jashtëkohshëm sepse, propozimi kishte me pasur logjikë në kohën kur është shpallur konkursi. Por, në kohën kur po përfundoj afati i konkursit, nuk ka logjikë që të kërkohet anulimi i konkursit... Por, a është propozimi i njëjte që, ne ta hedhim në votim...? Në fakt në rivotim...?

Stevan Veselinoviq: Unë mendoj që formimi i panelit është i lidhur direkt me vendimin, sepse sikur propozimi im të ishte marrë parasysh nuk ka qenë fare e nevojshme të merrej vendimi. Prandaj, vlerësoj se kjo është një çështje procedural që lidhet direkt me kërkesën time. Kërkesa ime është në përputhje me ligjet e KQZ-së, dhe për këtë ua kam dërguar në imell kërkesën. Tash, kjo është çështje e afateve dhe rivotimi i serishëm s'është çështje për mua...

Valdete Daka: Megjithatë, po e shohim që Stevani qëndron në propozimin e tij. Unë, nëse pajtoheni mendoj që ta hedhim në votim.

Adnan Rrustemi: Ta qartësojmë proceduralisht çështjen: E para, proceduralisht jemi në afate të mjaftueshme për ta themeluar panelin. E dyta: bëhet fjalë për propozimin e anëtarit të KQZ-së për ta anuluar konkursin, dhe tjetra, a kërkohet vendim i ri për panel ! Nëse kjo kërkohet, a duhet paraprakisht me e anulua vendimin që e kemi marrë, dhe pastaj...Mbase, z. Floriani mundet me na shpjegua...Të sqarojmë çdo gjë deri në fund, mos të shkaktojmë konfuzitet procedural...

Florian Dushi: Mbetem pranë qëndrimit se, me vetë faktin që e kemi votua panelin me shumicë vota, kemi dhënë përgjigje edhe sa i parkete idesë për anulimin e konkursit...Ka plotë momente të këitilla kur anëtarët, qoftë përmes votimit formal edhe qoftë atij deklarativ, e bëjnë të qartë qëndrimin e tyre. Kjo, nënkuptohet. Unë mendoj që efekti tek formimi apo vendimi për formim të panelit, kish me qenë vetëm në rast se vendoset me shumicë votash për me u anulua konkursi. Përndryshe, ne me mirëkuptim mundemi me ecë më tutje, përndryshe nuk ka efekt tjetër...

Valdete Daka: Unë, e hedh në votim propozimin e Stevanit me të gjitha arsyetimet e tij...

Rezultat është 8, me 1. Nuk aprovohet. Tash, panelin po e ri konfirmojmë panelin: kemi 1 abstenim, dhe 8 për panelin aktual.

5. Të ndryshme